



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR
TË GJIMNAZIT**

FUSHA: GJUHË SHQIPE – LETËRSI

LËNDA: LETËRSI

KODI: 4.2.11.Z

PROGRAMI I LËNDËS LETËRSI

PËR KLASËN E 11^{të}

TIRANË, DHJETOR 2009

Programi i lëndës së letërsisë si lëndë me zgjedhje është konceptuar në një modul të ndërtuar në bazë teme. Kjo ju jep mundësi nxënësve për të folur, dëgjuar, lexuar, shkruar, sidomos për të debatuar dhe gjykuar rreth problematikave dhe çështjeve të veçanta.

Programi i lëndës është i detyrueshëm për nxënësit që e zgjedhin. Programi realizohet nëpërmjet modulit me mesazhin “Bota dhe ndryshimi”, nëpërmjet temës qendrore “Rrënjët e formimit të kombit shqiptar”. Nëpërmjet këtij moduli, nxënës/it,-es i mundësohet formimi letrar që nga leximi, kuptimi, zbërthimi i përmbajtjes së veprës, deri tek analiza e plotë e saj, parashtrimi i qëndrimit të pavarur vlerësues, individual apo në grup.

1. SYNIMI I LËNDËS

- Të aftësojë nxënësin për të kuptuar, analizuar, gjykuar dhe vlerësuar veprën letrare, idetë dhe mesazhet që ajo përcjell.
- Të nxisë zhvillimin mendor dhe emocional të tyre.
- Të eksplorojnë veten dhe shoqërinë shqiptare në raport me rajonin e më gjerë.

Për realizimin e synimit të lëndës nxënësit duhet:

1. të kuptojnë, të zotërojnë dhe të përdorin **konceptet bazë** të lëndës;
2. të fitojnë shprehitë dhe aftësitë e nevojshme për **zbatimin e koncepteve bazë në kontekstin e veprës letrare** që studiojnë dhe, nëpërmjet saj, edhe në veprat të tjera me të cilat do të ballafaqohen;
3. të parashtrojnë, të mbrojnë, të **zhvillojnë idetë, qëndrimet, përfundimet dhe vlerësimet e tyre rreth veprës** në tërësi, aspekteve dhe elementëve të saj në veçanti;
4. të zhvillojnë, të konsolidojnë dhe të përsosin, në përputhje me mundësitë dhe interesat e tyre, **aftësitë e komunikimit gojor, shkrimor dhe pamor**;
5. të bëhen gjithnjë e më të përgjegjshëm e të pavarur për **mësimnxënien** dhe rezultatin e saj, të aftësohen për vetënxënie.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të programit të letërsisë nxënës/i,-ja:

- të aftësohet **për të analizuar veprën letrare** duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në grupe të vogla;
- **të parashtrojë idetë, qëndrimet e tij/saj** për autorin dhe veprën e studiuar dhe të reflektojë sipas sugjerimeve, ideve dhe vlerësimeve që japin të tjerët;
- **të diskutojë dhe bëjë punë të pavarur rreth ideve, analizave dhe vlerësimeve** për veprën;
- **të hulumtojë** informacione, vlerësime dhe qëndrime rreth autorit dhe veprës në tërësi;

- **të përgatisë dhe të parashtojë me gojë dhe me shkrim** punimet e tij/saj përgjithësuere për vlerësimin në fund të çdo tematike dhe në fund të modulit;
- të fitojë **aftësitë e të menduarit kritik** duke mësuar si t'u përqasen dhe si t'i studiojnë këto tekste;
- të aftësohet drejt **vlerësimit vetjak** të letërsisë.

Në këtë lëndë nxënësit, nëpërmjet veprës, rishikojnë:

- gjuhën dhe pasurinë e saj, pasurinë leksikore dhe hijeshinë e strukturave sintaksore, arkaizmat dhe neologjizmat;
- gjuhën në një krijim lirik dhe në një krijim epik;
- gjuhën e satirës;
- karakterin metaforik të gjuhës artistike;
- dialektet - gjuha letrare dhe prurjet gjuhësore letrare;
- shkrimin vlerësues, argumentues-shkencor;
- drejtshkrimin dhe pikësimin;
- aftësinë e kërkimit, e përzgjedhjes, e shfrytëzimit të burimeve.

Kritere të konceptimit të lëndës

Lënda e letërsisë si lëndë me zgjedhje është konceptuar :

- **në modul mësimor;**
- kriteri parësor i studimit të saj është **kriteri tematik, i ndërthurur natyrshëm me kriterin e gjinisë letrare;**
- **në njësi mësimore** që zbërthehen në tematika dhe çështje mësimore;
- në përdorimin e sa më shumë **burimeve alternative**, tradicionale dhe multimediale;
- në **lirinë dhe krijimtarinë e planifikimit dhe realizimit të njësisë**, në fleksibilitetin e përcaktimit dhe shpërndarjes së orëve midis njësisve mësimore dhe brenda njësisë, në përzgjedhjen nga mësuesi dhe vetë nxënësi të veprimtarive të nxënies më të përshtatshme për arritjen e objektivave;
- në **dallimin qartë të vlerësimit diagnostikues, motivues dhe plotësues** gjatë procesit të nxënies **nga vlerësimi përmbledhës në përfundim** të tij;
- në **objektivizmin e procesit të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit** duke e lidhur ngushtësisht atë me arritjen e objektivave dhe rezultateve të nxënies;
- në të **mësuarit me qendër nxënien** duke i dhënë përparësi veprimtarive të larmishme të nxënies që aktivizojnë proceset e larta të të menduarit dhe dokumentojnë qëndrimin individual të nxënësit në lidhje me tematikat, çështjet kryesore të lëndës;
- në **integrimin e natyrshëm, jo vetëm të lëndës së letërsisë me gjuhën, por edhe me lëndë të tjera** nëpërmjet lidhjes, referimit dhe demonstrimit të njohurive, shprehive dhe aftësive përkatëse në kontekstin e analizës së thelluar të veprës letrare dhe parashtrimeve individuale me gojë dhe me shkrim të nxënësit.

Mësues/i,-ja i/e lëndës së letërsisë (me zgjedhje) duhet:

- të kuptojë dhe zbërthejë tematikat dhe çështjet e njësisë mësimore; t'i lidhë ato me objektivat dhe me vlerësimin e nxënësit sipas rezultateve të nxënies;
- të përzgjedhë, të përdorë e të pasurojë burime alternative për mësimdhënien dhe sidomos për mësimnxënien e suksesshme;
- të zgjerojë e të thellojë përgatitjen individuale në aspektin shkencor dhe didaktik;
- të zotërojë, të përdorë dhe të zgjerojë aftësitë në lidhje me metodat aktive të të mësuarit të lëndës që mundësojnë mësimin me qendër veprimtarinë e nxënësit;
- të reflektojë nëpërmjet vlerësimit në proces dhe vlerësimit përmbledhës për alternativa të reja në dobi të rritjes së cilësisë së mësimdhënies për nxënie .

Moduli i bazuar në tematikë dhe çështje:

- ndihmon nxënësit të mësojnë gjuhën duke folur, dëgjuar, shkruar, lexuar, paraqitur dhe parë problematika, bindje dhe supozime rreth jetës dhe botës, si dhe rreth gjuhës dhe teksteve që i shprehin ato;
- mundëson një studim ndërlëndor;
- duke u përdorur si një kornizë referuese për diskutim dhe kërkim, synon që nxënësit të përdorin gjuhën dhe rregullat e saj në mënyrë të qëllimtare dhe efikase, ndërkohë që përpunojnë informacionin, marrin vendime, zgjidhin problemin dhe mendojnë në mënyrë krijuese dhe kritike;
- integron proceset gjuhësore.

Moduli i bazuar tek burimet:

- nxit nxënësit dhe mësuesit të përdorin një larmi burimesh për nxënien dhe mësimdhënien e tyre. Mësuesit nxiten të përzgjedhin dhe përshtatin materiale, të përshtatin mësimin dhe mjedisin e tyre për të plotësuar aftësitë, nevojat dhe interesat e secilit prej nxënësve;
- pasuron vlerësimin e nxënësit dhe zgjeron përvojat e tyre letrare me materialet burimore;
- mundëson personalizimin e orës së mësimit duke e përshtatur atë me veçoritë e mjedisit mësimor, me veçoritë e nxënësve konkretë.

Moduli i bazuar në veprimtari të larmishme nxënieje

Duke synuar aftësimin e nxënësit për të analizuar, gjykuar dhe mbajtur qëndrim ndaj veprës letrare, ideve dhe mesazheve që ajo përcjell, procesi mësimor do të mbështetet në përdorimin e një larmie aktiviteteve nxënieje, nga diskutimet në grup, tek ushtrimi sistematik i nxënësit në punimet me shkrim dhe prezantimet gojore.

Ky proces nxënieje do t'i ndihmojë nxënësit të formojnë aftësitë e të menduarit kritik, të përmirësojnë të kuptuarin përmes leximit dhe të japin reagimet e tyre të argumentuara për atë që lexojnë, shkruajnë, paraqesin dhe diskutojnë.

Moduli i bazuar në vlerësimin më objektiv të formimit të nxënësit

Nxënësit do të vlerësohen gjatë dhe në përfundim të procesit të nxënies për:

- shtjellimin e tematikave dhe çështjeve të ndërthurura dhe integruese brenda lëndës, fushës si dhe me fushat e tjera kurrikulare;
- pjesëmarrjen në diskutime formale e informale;
- hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve alternative;
- përgatitjen dhe prezantimin e ideve, gjykimeve dhe qëndrimeve të tyre nëpërmjet parashtrimeve gojore dhe punëve me shkrim.

3. OBJEKTIVA TW MODULIT

MODULI: BOTA DHE NDRYSHIMI

Tema qendrore: Rrënjët e formimit të kombit shqiptar.

(“Lahuta e Malcis”, Gjergj Fishta)

Orë mësimore: 72 orë

Struktura e modulit: Moduli përbëhet nga pesë njësi mësimore. Secila njësi mësimore trajton një tematikë të caktuar, të zbërthyer në nëntematika e çështje mësimore: (1) “Lahuta e Malcis”, aspekti historik; (2) “Lahuta e Malcis”, aspekti mitologjik; (3) “Lahuta e Malcis”, krahasimi me “Historinë e Skëndërbeut” të Naim Frashërit, “Milosaon” të De Radës, “Këngën e Sprasme të Balës” të Gavril Darës, “Te dheu i huaj” të Skiroit, si dhe me vepra të tilla, si: “Iliada” dhe “Odisea”, “Eneida”, “Nibelungët”; (4) “Lahuta e Malcis”, krahasuar me veprat e tjera të Fishtës; dhe (5) Diskutimi përmbyllës: Vendi i “Lahutës së Malcis” në letërsinë shqiptare, vlerësime pro dhe kundër.

Në këtë modul nxënësit parashtrojnë, ballafaqojnë dhe rrisin aftësitë e tyre në:

- pasqyrimin nëpërmjet letërsisë të kontekstit historik, mitologjik, politiko-shoqëror, kulturor e filozofik;
- eksplorimin e të shkruarit vlerësues dhe argumentues-shkencor;
- përdorimin e termave letrare;
- pasurimin e fjalorit;
- përdorimin në komunikim të strukturave gramatikore të përzgjedhura;
- rritjen e kompetencës për komunikim me shkrim dhe me gojë.

Në këtë modul nxënësit do të eksplorojnë veten dhe shoqërinë shqiptare në raport me rajonin e më gjerë. Çështja shtrohet: “Ç’kuptim kanë shprehjet “Unë jam shqiptar, ne jemi shqiptarë” në këtë botë të ndryshueshme nga epoka në epokë, nga viti në vit, nga çasti në çast?” Për një mesazh të rëndësishme si “Bota dhe ndryshimi” pyetja mund të formulohet: “A ka vlerë trashëgimia kulturore apo gjithçka që lidhet me një komb vendoset me beteja a ngjarje të ngjashme të reklamuar si përcaktuese në histori?” Me fjalë të tjera: “Cilat janë vlerat e “ushqimit” që vjen nga rrënjët dhe të “ushqimit” që vjen prej degëve?”

Vepra që do të lexohet, analizohet dhe diskutohet

“Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës, poemë epike me lëndë nga historia politike e Shqipërisë në shekullin e 19-të deri në dekadën e parë të shekullit të 20-të, kur u krijua shteti i pavarur.

Temat qendrore mësimore

- **Tema e qëndresës kulturore** – me lëndë nga historia shumëshekullore e popullit dhe mitologjia kombëtare.
- **Populli** – bartës, konservues dhe zhvillues i vlerave të reja kulturore në epoka të ndryshme dhe çaste vendimtare të mbijetesës kombëtare.
- **Letërsia gojore dhe letërsia e kultivuar**; epopeja lind atëherë kur fillojnë të dallohen disa prej tipareve të kombit.

Konceptet letrare

Në fokus të procesit mësimor do të jetë përvetësimi i koncepteve bazë të lëndës. Konceptet që janë dhënë në vitet e mëparshme, shërbejnë si bazë për t’u thelluar, apo konsoliduar në kontekste të reja letrare.

Konceptet bazë të lëndës lidhen me gjininë letrare: **poezinë**.

Konceptet më specifike, karakteristike për gjininë epike, të shtjelluara në modulin e programit të klasës së 11-të, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Gjinia letrare:	Konceptet kryesore
Epika	
Poezia si gjini, format e saj	<ul style="list-style-type: none"> • poema; • poema epike dhe poema epike; • epizmi, lirezmi; • metonimia, simboli;

	<ul style="list-style-type: none"> • ironia; • subjekti, episodi, cikli i episodeve; • struktura e një vepre epike, narracioni, përshkrimi, detaji; • personazhi historik, figura mitologjike, realja dhe e trilluara; • gjuha dhe pasurimi i saj nga poetët; pasuria leksikore dhe e strukturave sintaksore, arkaizmat, neologjizmat, dialektalizmat; • metrika: rimat, ritmi, strukturat ritmike të 8-rrokeshit; • tropet; • stili, etj.
--	--

NJËSIA MËSIMORE 1. Orë të sugjeruara: 12 orë

“Lahuta e Malcis”, aspekti historik.

Blloku tematik	Objektivat mësimorë
<p>1. Historia e shqiptarëve si konflikt etnik e historik.</p> <p>2. Letërsia e kultivuar dhe folklori.</p>	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë lidhjen midis veprës, historisë kombëtare e më gjerë dhe historisë së shkurtër të krijimit të veprës letrare; • të analizojë narracionin, gjuhën poetike dhe elementet e tjera të mjeshtërisë artistike; • të dallojë veçoritë e poemës epike; • të parashtojë qëndrimin e tij/saj ndaj veprës.

TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

TEMATIKAT	ÇËSHTJET MËSIMORE
1. Historia e shqiptarëve si konflikt etnik e historik.	<ul style="list-style-type: none"> • Rrethanat historike e politike të mjedisit shqiptar. • Cikli i Oso Kukës. • Krijimi i figurës së luftëtarit shqiptar. • Personazhet : protagonistë / antagonistë; historikë / mitologjikë. • Shkrimi argumentues-shkencor. • <i>Punë me shkrim</i> • Cikli i Lidhjes së Prizrenit, i Marash Ucit dhe i Pater Gjonit etj. • Personazhet: protagonistë, antagonistë e mitologjikë. • Shkrimi argumentues-shkencor. • <i>Punë me shkrim.</i>

2. Letërsia e kultivuar dhe folklori.	<ul style="list-style-type: none"> • Një vepër e madhe dhe e papërsëritshme në llojin e vet – modeli i eposit poetik kombëtar. • “Një dritë jete homerike shkëlqen mbi veprën e tij: si në dukje të zanave që u përngajnë Dianës e Atenës, si së fundi në përshkrimin e figurave heroike dhe të një bote, e cila të tërheq me thjeshtësinë e saj heroike ...”.(E.Cabej) • Struktura e poemës “Lahuta e Malcis”. • “Lahuta e Malcis” dhe modeli antik i epit. • Veçori stilistiko – figurative; hiperbola, krahasimi, epiteti, pasthirrma, apostrofi. • Shkrimi argumentues-shkencor. • <i>Punë me shkrim.</i>
---------------------------------------	--

Burimet mësimore bazë:

- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 4 Epika”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2003.
- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 1-10”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2001-2007.
- Artikuj të ndryshëm që përputhen me objektin.

Burime ndihmëse:

- Uçi Alfred: “Mitologjia, folklori, letërsia”, Tiranë 1982.
- Fjalorë terminologjikë, fjalorë të termave letrarë.
- Enciklopedi .
- Media.
- Interneti.

NJËSIA MËSIMORE 2. Orë të sugjeruara: 14 orë

“Lahuta e Malcis”, aspekti mitologjik.

Bloku tematik	Objektivat mësimorë
<p>1. Zanat dhe Orët në Lahutën e Malcisë.</p> <p>2. Dragonjtë dhe kuçedra.</p> <p>3. Lugetërit dhe shtrigat.</p>	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të njohë mitologjinë shqiptare të rikrijuar në poemën “Lahuta e Malcis”; • të reflektojë rreth lidhjeve të saj me mitologjinë popullore; • të analizojë origjinalitetin e Fishtës në rikrijimin e figurave mitologjike; • të eksplorojë vlerat artistike, kalimin nga realja te

<p>4. Floçka.</p> <p><i>Diskutim.</i></p>	<p>jorealja; funksioni i hiperbolës;</p> <ul style="list-style-type: none"> të parashtrijë qëndrimin e tij ndaj veprës.
--	--

TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

TEMATIKAT	ÇËSHTJET MËSIMORE
<p>1. Zanat dhe Orët (Kënga “Ali Pasha i Gucisë”, cikli i Tringës etj).</p>	<ul style="list-style-type: none"> Kombi shqiptar i ka rrënjët thellë në mitet e veta. Lufta e qenieve mitologjike është po aq e rreptë sa ajo e njerëzve. Përfytyrimi popullor mbi Zanat dhe Orët. Zana e Frymëzimit e identifikuar si Zana e Veleçikut është thirrur në Lahutë të Malcis, jo vetëm si një <i>alter autor</i>, por edhe si një <i>alter ego</i>. Zana – personazh. Trajta tregimtare gërshetuar me dialogë të gjatë. Magjia e penës poetike të Fishtës. Përsëritja e fjalëve dhe strukturave sintaksore. <i>Punë me shkrim.</i>
<p>2. Dragonjtë dhe kuçedra (Kënga “Kuçedra” dhe kënga XXVI).</p>	<ul style="list-style-type: none"> Konflikti universal midis së mirës dhe së keqes. Dragonjtë -e Lahutës së Malcis, figura mitologjike të folklorit shqiptar,- nuk janë gjë tjetër veçse vetë luftëtarët malësorë, të njohur historikisht, që fantazia popullore i ka mbrytur me elemente të mbinatyrshme. Kuçedra – retrospektivë mitologjike. Përsëritja e fjalëve dhe strukturave sintaksore. Leksiku i pasur. Strukturimi gjuhësor dhe ritmik. Nënshtresat gjuhësore. <i>Punë më shkrim.</i>
<p>3. Lugetërit dhe shtrigat (Kënga “Lugati” etj).</p>	<ul style="list-style-type: none"> Lugati në mitologjinë popullore. Lugetërit dhe shtrigat si figura fantastike të besimeve popullore. Lugetërit dhe shtrigat – personazhe antagonistë. Ironia e grotesku tek Fishta. Përsëritja e fjalëve dhe strukturave sintaksore. Leksiku i pasur. Strukturimi gjuhësor dhe ritmik.

<p>4.Floçka (Kënga e 26-të).</p> <p><i>Diskutim</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nënshtrësuarat gjuhësore. • <i>Punë më shkrim</i> . • Paralel me historinë iliro-shqiptare kanë bashkëjetuar dhe mitet: Zanat e Orët e Maleve, kuçedrat e floçkat etj. • Floçkat, qeniet mitologjike përballë Zanës së Frymëzimit, gjithashtu qenie mitologjike, kanë një thelb të përbashkët – personifikojnë gruan në gjendjen e saj më të fuqishme emocionale. • Përsëritja e fjalëve dhe strukturave sintaksore. • Leksiku i pasur. • Strukturimi gjuhësor dhe ritmik. • Gjuha në një krijim lirik dhe në një krijim epik. • Nënshtrësuarat gjuhësore. • <i>Punë me shkrim</i>. • <i>Diskutim 1:</i>Lahuta e Malcis është: <ul style="list-style-type: none"> ○ një vepër historike; ○ një trillim fantastik; ○ një memorial i një analisti të situatës ndërkombëtare; ○ një poemë epike –heroike. • <i>Diskutim 2:</i> Miti dhe antimiti fishtjan. <p><i>Punë me shkrim</i> : Shkruani një ese argumentuese –shkencore lidhur me tematikat e diskutimit.</p>
--	---

Burimet mësimore bazë:

- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 4 Epika”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2003.
- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 1-10”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2001-2007.
- Artikuj të ndryshëm që përputhen me objektin.

Burime ndihmëse:

- Fjalorë terminologjikë, fjalorë të termave letrarë.
- Enciklopedi .
- Media.
- Interneti.

NJËSIA MËSIMORE 3. Orë të sugjeruara: 20 orë

“Lahuta e Malcis”, krahasuar me: “Historinë e Skëndërbeut” të Naim Frashërit, “Milosaon” e De Radës, “Këngën e sprasme të Balës” të Gavril Darës, “Te dheu i huaj” të Skiroit, si dhe me vepra të tilla, si: “Iliada” dhe “Odisea” të Homerit, “Eneida” të Virgjilit, “Nibelungët” të Epit gjerman.

Blloku tematik	Objektivat mësimorë
<p>I.</p> <p>Kombëtarja në letërsinë gojore, te Naim Frashëri, De Rada, Gavril Dara, Zef Skiroi etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jeronim De Rada, “Milosao”. • Gavril Dara i Ri, “Kënga e sprasme e Balës”. • Zef Skiroi, “Te dheu i huaj”. • Shqiptarët dhe historia e tyre. <p>II.</p> <p>Poema epike lind kur krijohen kombet (krahasuar me Iliadën, Eneidën, Nibelungët)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Homerit, “Iliada”. • Virgjilit, “Eneida”. • Epi gjerman “Nibelungët”. 	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të parashtrorë, nëpërmjet krahasimit, të përbashkëtat dhe dallimet midis veprës së Fishtës dhe atyre të De Radës, Gavril Darës e Skiroit në rrafshin e letërsisë kombëtare dhe atyre të Homerit, Virgjilit, Epit gjerman në rrafsh botëror; • të eksplorojë shkrimin përshkrues.

\

TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

I. Kombëtarja në letërsinë gojore dhe në poemën e Naim Frashërit, Jeronim de Radës, Gavril Darës i Riu, Zef Skiroit etj.

Njohuri paraprake të domosdoshme:

1. **Jeronim de Rada, “Milosao”**: koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua; poemë liriko-epike; jehona e shekullit XV në poemë.
2. **Gavril Dara i Riu, “Kënga e sprasme e Balës”**: koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua; poemë epiko-lirike; jehona e shekullit XV në poemë.
3. **Zef Skiroi, “Te dheu i huaj”**: koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua; poemë epike; jehona e shekullit XV në poemë.
4. **Shqiptarët dhe historia e tyre**, si mundësi për të shprehur jehona të ndryshme shpirtërore.

Autori / Vepra	ÇËSHTJET MËSIMORE
<p>Jeronim de Rada</p> <p>“Milosao”</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Vërtetësimi i të kuptuarit. • Vepra, autori dhe periudha letrare. • Koha kur u shkrua. • Konflikti: intriga – kohezioni. • Personazhet: nënë Madhja, Milosao dhe Rina. • Personazhe historikë dhe mitologjikë; personazhe të krijuar. • Kompozicioni. • Vargu. • Mbështetja në folklor. • Shkrimi përshkrues. • <i>Punë me shkrim.</i>
<p>Gavril Dara i Ri</p> <p>“Kënga e sprasme e Balës”</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Vërtetësimi i të kuptuarit. • Vepra, autori dhe periudha letrare. • Raporti ndërmjet notave epike me ato lirike e dramatike në rikrijimin e epokës së Skënderbeut. • Ndikimi nga letërsia klasike greke e latine, me praninë e elementit mitologjik. • Analiza e elementeve të trillimit. • Personazhet: të marra nga poezia popullore, nga historia ose të krijuara nga autori. Shkrirja e tipareve të heronjve të letërsisë kalorësiake dhe atyre popullore. • Stilistika letrare: antiteza, krahasimi, metafora, epiteti. • Gjinia letrare: poema epiko- lirike, lloji i vargut, rima,

	<p>muzikaliteti, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkrimi përshkrues. • <i>Punë me shkrim.</i>
<p>Zef Skiroi,</p> <p>“Te dheu i huaj”</p> <p>(varianti I)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Vërtetësimi i të kuptuarit. • Lidhja midis veprës, autorit dhe periudhës letrare. • Një poemë domethënëse e letërsisë arbëreshe. • Ngjarjet më të rëndësishme që nga koha e Skënderbeut deri në shekullin XIX, ku shkrihen historia, mitologjia, folklori. • Personazhe historike dhe mitologjike; personazhe të krijuara. • Analiza e elementeve të trillimit. • Hiperbola. • Gjinia letrare: poemë epiko- lirike, lloji i vargut, rima, etj. • Shkrimi përshkrues. • <i>Punë me shkrim.</i>

II. Poema epike lind kur krijohen kombet (krahasuar me Iliadën, Eneidën, Nibelungët etj).

1. **Homeri, “Iliada”:** koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua.
2. **Virgjili, “Eneida”:** koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua.
3. **Epi gjerman, “Nibelungët”:** koha kur u shkrua; qëllimi përse u shkrua.

<p>Homeri</p> <p>“Iliada”</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Sinteza e një periudhe kalimtare (të ndërmjetme), që shkon nga stadi i barbarisë deri në atë të qytetërimit të shoqërisë njerëzore. • Konflikti mitologjik dhe reflektimi historik. • Heronjtë homerikë dhe epoka e tyre. • Mjeshtër i paarritshëm në plazmimin e karaktereve të zotave dhe heronjve. • Historia tregohet në poemë në formë gjysmë mitike, duke përzier zotat me njerëzit. Personazhet, karakterizimi. • Gjuha dhe figuracioni bazë në një vepër epike. • Homerit dhe epepeja e shqiptarëve; Fishta dhe Homerit. <p><i>Punë me shkrim :</i> (Ndeshja midis dy kryetrimave – fitorja ose humbja e tyre shkaktohet nga zotat). Shkruani një ese argumentuese. Homerit do të na thotë se: “Gjithçka në jetën e njeriut është e caktuar nga Fati “.</p>
---	--

Virgjili “Eneida”	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Subjekti. • Zanafilla legjendare e Romës së lashtë. • Mitologjia romake. • Toni epik e fryma lirike e poemës; theksat ritmikë, vargu. • Figurat letrare – bartja. • <i>Punë me shkrim.</i>
Epi gjerman “Nibelungët”	<ul style="list-style-type: none"> • Leximi. • Subjekti. • Mitologjia gjermanike. • <i>Punë me shkrim.</i>

Burimet mësimore bazë:

- Naim Frashëri, “Histori e Skënderbeut”.
- Gavril Dara i Ri, “Kënga e sprasme e Balës”.
- Zef Skiroi, “Te dheu i huaj”.
- Homeri, “Iliada” dhe “Odisea”.
- Virgjili, “Eneida”.
- Epi gjerman, “Nibelungët”.

Burime ndihmëse:

- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësit.
- Fjalorë terminologjikë, fjalorë të termave letrarë.
- Enciklopedi .
- Media.
- Interneti.

NJËSIA MËSIMORE 4. Orë të sugjeruara: 15 orë

“Lahuta e Malcis”, krahasuar me veprat e tjera të Fishtës.

Blloku tematik	Objektivat mësimorë
1. Lirikat e Fishtës. 2. Satirat. 3. Dramaturgjia.	Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> • të parashtrijë, argumentojë dhe evoluojë idetë e

4. Eseistika.	<p>qëndrimet e tij/saj rreth vlerave të veprës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të eksplorojë burime dhe të diskutojë rreth një çështjeje, si p.sh.: fokusimi në tematikën kombëtare në të gjitha gjinitë e trajtuara prej Fishtës; • të eksplorojë shkrimin vlerësues.
---------------	--

TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

Ndërkohë që Fishta shkruante “Lahutën e Malcis”, ishte aktiv si poet lirik e satirik, si dramaturg dhe eseist. Në *Lahutë* do të gjejmë edhe lirikën, ironinë e hollë dhe sarkazmën therëse dhe, veçanërisht, frymën e kohës të periudhës 1902-1937.

Tematikat	ÇËSHTJET MËSIMORE
<ol style="list-style-type: none"> 1. Lirikat e Fishtës. 2. Satirat. 3. Dramaturgjia. 4. Eseistika. 	<ul style="list-style-type: none"> • Fishta poet lirik. • Publicistika satirike. • Fishta dramaturg, eseist. • Tematika kombëtare në të gjitha gjinitë e trajtuara nga Fishta. • Gjuha dhe pasuria e saj, pasuria leksikore, arkaizmat dhe dialektalizmat. • Ironia e hollë, sarkazma therëse, dialogu në veprat e Fishtës. • Ndërtimi i hiperbolës në vargjet e Fishtës. • Shprehjet frazeologjike në krijimtarinë e Fishtës. • Figurat stilistike bazë mbi të cilën ngrihen figurat e tjera; realizimi artistik e gjuhësor i tyre; funksioni stilistik që luajnë. • Përdorimi i pjesores nga Fishta. • Shkrimi vlerësues. <p><i>Punë me shkrim</i> : shkruani një ese (shkrimi vlerësues)</p> <p>” Tradita popullore dhe origjinaliteti fishtian”.</p>

Burimet mësimore bazë :

- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 4 Epika”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2003.
- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 1-10”, Enti Botues: Gjergj Fishta, Lezhë 2001-2007.
- Artikuj të ndryshëm që përputhen me objektin.

Burime ndihmëse:

- Fjalorë terminologjikë, fjalorë të termave letrarë.
- Enciklopedi .
- Media.
- Interneti.

NJËSIA MËSIMORE 5. Orë të sugjeruara: 11 orë

Vendi i “Lahutës së Malcis” në letërsinë shqiptare, vlerësime pro dhe kundër.

Diskutim përmbyllës.

TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

Në këto orë të diskutimit përmbyllës, mësues/i,-ja do të zgjedhë vetë objektin e debatit që do të zhvillojë për çdo javë duke u nisur nga literatura pro e kundër me të cilën kanë rënë në kontakt nxënësit gjatë kohës që janë përgatitur në mënyrë të pavarur për çdo njësi mësimore, por ai duhet t’u përmbahet objektivave.

Tematikat për diskutimin përmbyllës:

1. Kombëtarja në kushte historike të përcaktuara dhe në epokën e globalizmit.
2. Gjuha letrare dhe prurjet gjuhësore letrare para institucionalizimit të saj; trashëgimia letrare-kulturore e një populli dhe zhvillimet moderne e postmoderne të artit etj.
3. Identiteti kombëtar.

Bloku tematik	Objektivat mësimorë
<ol style="list-style-type: none">1. Kombëtarja në kushte historike të përcaktuara dhe në epokën e globalizmit.2. Gjuha letrare dhe prurjet gjuhësore letrare para institucionalizimit të saj, trashëgimia letrare-kulturore e një populli dhe zhvillimet moderne e postmoderne të artit etj.3. Identiteti kombëtar.	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të parashtrijë, argumentojë dhe evoluojë idetë e qëndrimet e tij pro dhe kundër rreth vlerave të <i>Lahutës</i> në raport me letërsinë shqiptare;• të eksplorojë burime dhe të diskutojë pro e kundër rreth një çështjeje, si p.sh.: kombëtarja në kushte historike të përcaktuara dhe në epokën e globalizmit; gjuha letrare dhe prurjet gjuhësore letrare para institucionalizimit të saj, trashëgimia letrare-kulturore e një populli dhe zhvillimet moderne e postmoderne të artit etj.;• të eksplorojë shkrimin vlerësues përmes një

	<p>eseje letrare, temën e së cilës duhet ta zgjedhë vetë nxënës/i,-ja;</p> <ul style="list-style-type: none"> të vërë në pah identitetin gjuhësor, letrar-artistik, fetar etj. si pjesë e identitetit kombëtar.
--	--

Rubrika: Takim me fishtologë

Tematika	Çështje mësimore
<ul style="list-style-type: none"> Si e përçojnë kulturën e popullit shkrimtarët? Si ndikon kultura në formimin e individit? Si më ndihmon debati me autorët dhe me lexuesit e tyre të përcaktoj identitetin tim dhe vlerat e mia? 	<ul style="list-style-type: none"> Trajtimi i gjuhës, kultura e të shkruarit; individualiteti në komunikim. Shkrimi përshkrues e bindës: analizë dhe praktikë. Rishikimi dhe redaktimi i punimit. Progresi në të shkruar.

Portofoli im: dokumentimi i progresit përmes punimeve të përzgjedhura

- Mbledhja e ideve për një vlerësim (me bllokun e shënimeve).
- Shkrimi krijues: këndvështrimi juaj mbi Lahutën (këngët: Kuçedra; Jeta e Re; episodi i Tringës etj.)
- Shkrimi krijues: Shkruani, përmbledhjen e një kënge që ju ka pëlqyer më shumë, jepni gjykimin tuaj për të.
- Kërkime / studime sociale: Diskutim: rreth identitetit shqiptar.
- Çfarë mësuat ju në këtë kurs: reflektim.

Burimet mësimore bazë:

- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 4 Epika”, Enti Botues Gjergj Fishta, Lezhë 2003.
- Gjergj Fishta, “Vepra letrare 1-10”, Enti Botues Gjergj Fishta, Lezhë 2001-2007.
- Artikuj të ndryshëm që përputhen me objektin.

Burime ndihmëse :

- Fjalorë terminologjikë, fjalorë të termave letrare.
- Enciklopedi.
- Media e shkruar dhe elektronike.
- Interneti.

4. KËRKESA TË LËNDËS SË LETËRSISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Letërsia	Historia
Të lexuarit	Nxënës/i,-ja:
Të shkruarit	<ul style="list-style-type: none"> të përdorë ngjarjet historike për të kuptuar dhe për të interpretuar veprën letrare.
Të kuptuarit	
Të interpretuarit	
Letërsia	Arti Pamor
Të lexuarit	Nxënës/i,-ja:
Të shkruarit	<ul style="list-style-type: none"> të interpretojë karakteristikat e veprave të artit pamor në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme kulturore; të përdorë elementet dhe parimet e artit pamor për të shprehur emocionet e marra nga një tekst.
Të kuptuarit	
Të interpretuarit	
Letërsia	Teknologji
Të lexuarit	Nxënës/i,-ja:
Të shkruarit	<ul style="list-style-type: none"> të shkruajë në Word tekste të llojeve të ndryshme; të përdorë programin Power Point për të bërë prezantime të ndryshme; të përdorë internetin për të nxjerrë informacione të ndryshme për letërsinë; të përdorë mjete të ndryshme elektronike, si: kompjuter, magnetofon, diktofon, video për qëllime të ndryshme.
Të kuptuarit	
Të interpretuarit	
Letërsia	Filozofia
Të lexuarit	Nxënës/i,-ja:
Të shkruarit	<ul style="list-style-type: none"> të interpretojë vepra dhe rryma të ndryshme filozofike të periudhave të ndryshme kohore.
Të kuptuarit	
Të interpretuarit	
Letërsia	Psikologjia
Të lexuarit	Nxënës/i,-ja:
	<ul style="list-style-type: none"> të interpretojë lidhjen e elementeve psikologjike me karakteret e

Të shkruarit	personazheve dhe të figurave të ndryshme të botës së letrave.
Të kuptuarit	
Të interpretuarit	

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për t'u zbatuar në lëndën e letërsisë, si lëndë me zgjedhje. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare, ku bën pjesë edhe kjo lëndë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- synimeve të linjave ndërkurrikulare;
- vlerësimin të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënies/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore e fetare.

Kërkesa të veçanta të lëndës së letërsisë

Mësimdhënia e letërsisë duhet të përmbajë jo vetëm transmetimin e njohurive për veprat letrare, por, ç'është më e rëndësishme, duhet të synojë zhvillimin e aftësive të nxënës/it,-es për të shijuar e vlerësuar në mënyrë kritike letërsinë.

Në mësimdhënien e letërsisë theksi duhet të vihet në krijimin e mundësive, që do t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë si për të reaguar me ndjeshmëri dhe kënaqësi

ndaj veprave letrare, ashtu dhe për t'i analizuar ato në mënyrë kritike. Për të realizuar këtë, mësuesit duhet të përdorin si mjeshtërinë, ashtu edhe shkencën e mësimitdhënies.

Përmbajta e lëndës do të ketë karakter të theksuar zbatues, duke mënjanuar e minimizuar karakterin parashtrues dhe informues.

Në thelb **procesi mësimor ka nxënien nga të gjithë nxënësit**, pavarësisht nga dallimet e tyre në interesa, njohuri dhe shprehje paraprake. Ndaj, në qendër të zbatimit të programit është **ballafaqimi i drejtpërdrejtë i nxënësit me veprën**, aftësimi i tij për të evidentuar vlerat, për të mbajtur një qëndrim vetjak ndaj veprës, duke shmangur kështu parashtrimin e njëanshëm të saj nga mësuesi.

Në fillim të lëndës **mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me natyrën e zhvillimit të saj**, me përmbajtjen e modulit, me çështjet që do të trajtojnë. **Temat e njësive mësimore të modulit janë orientuese**; nxënësit në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me mësuesin mund të propozojnë edhe ndonjë temë tjetër brenda modulit.

Moduli ka në qendër diskutimin, debatin. Ai mbështetet në punën e pavarur, kërkimore të burimeve që i duhen nxënësit për orën e mësimit. Për trajtimin e temave të modulit **mësuesi të përdorë punën individuale dhe në grupe**. Gjithashtu, **brenda çdo njësie mësimore nxënësit zhvillojnë punë me shkrim** në përputhje me kërkesat duke realizuar objektivat kryesore.

Brenda njësisë mësimore nxënësit do të zhvillojnë dhe orët e diskutimit. Tematika e diskutimit është orientuese, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit mund të propozojnë dhe zhvillojnë tematika të tjera për diskutim. Kujdes duhet të bëjë mësuesi për organizimin e nxënësve për orën e diskutimit.

Moduli **mbështetet në njohuritë paraardhëse të nxënësit** në lëndët: gjuhë shqipe, folklor, histori, gjeografi, shkenca sociale. Këto njohuri nxënësit do t'i pasurojnë dhe do t'i thellojnë nëpërmjet debatit dhe punës në grup.

Vepra letrare, e përzgjedhur për zbrëthimin e idesë madhore, **duhet të lexohet nga nxënësit. Nxënësit duhet të kenë veprën letrare si mjet pune**, për zhvillimin e njësisë mësimore.

Në qendër do të jetë **puna e pavarur dhe në grupe të vogla e nxënësit**, për të kuptuar konceptet e strategjitë bazë, që mundësojnë analizën e pavarur të veprës letrare.

Procesi i nxënies do të mbështetet shumë në hulumtimin e informacionit dhe lirinë e përzgjedhjes e të shprehjes së mendimeve të nxënësit për autorin dhe veprën letrare.

Vlerësimi i nxënësit do të bazohet në kritere të qarta e të shpallura për të gjykuar objektivisht për vlerat formuese që përfaqësojnë punimet me shkrim dhe prezantimet me gojë të nxënësit .

Lënda do të ofrojë mundësi sistematike e të larmishme që nxënësi të demonstrojë gjatë procesit të nxënies dhe në përfundim të tij formimin letrar të synuar, të lidhur ngushtë me objektivat e modulit.

Roli i mësuesit

Mësuesi është transmetues i njohurive. Ai luan një rol kyç për të lehtësuar studimin e letërsisë dhe për të zhvilluar aftësitë e nxënësit për nxënie të pavarur. Për të realizuar misionin e tij mësuesi duhet të inkurajohet që :

- të bashkëbisedojë me nxënësit synimet e nxënies dhe përmbajtjen;
- të ruajë një atmosferë pozitive dhe harmonike për nxënien;
- të mbështesë pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- të veprojë si një model i një nxënësi të letërsisë;
- ta përshtasë mësimdhënien me reagimet e nxënësit;
- të nxisë cilësinë e bashkëveprimit në klasë;
- të japë orientimet e duhura dhe *feedback* cilësor;
- të nxisë nxënien e pavarur.

Mësuesi duhet të përgatisë (ose përzgjedhë) instrumente didaktikë për aftësimin e nxënësit në analizën e pavarur të veprës.

Rolet e nxënësve

Për të realizuar misionin e tyre nxënësit kanë nevojë:

- t'i lexojnë vetë veprat, literaturën bazë dhe ndihmëse, dhe të sigurohen që po aftësohen si t'i diskutojnë ato në mënyrë kritike;
- të ushtrojnë imagjinatën e tyre, të reagojnë me emocion dhe të krijojnë tekstet e tyre;
- të shpjegojnë qartë opinionet dhe idetë e tyre, në një punë grupi;
- të zhvillojnë një fjalor kritik;
- t'i qasen tekstit letrar në mënyrë kritike;
- t'u besohet, të reflektojnë dhe të jenë të gatshëm të ndajnë me të tjerët punimet e tyre me shkrim si dhe punimet e të tjerëve.

Nxënësi, gjatë dhe në përfundim të çdo teme të programit, duhet të bëjë përzgjedhjen e punimeve për të ndërtuar dosjen e punimeve të tij më të arrira.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi, mësimdhënia dhe nxënia janë të lidhura pazgjidhshmërisht midis tyre, pasi së bashku mundësojnë dhe dokumentojnë arritjen e objektivave të nxënies.

Mësimdhënia dhe nxënia janë të pandashme në procesin mësimor. Mësimdhënia që nuk rezulton në nxënie për të gjithë nxënësit, çon në dështimin e procesit mësimor, në formalizmin e tij. Nxënia përbën dhe thelbin e procesit mësimor, kriterin bazë për të gjykuar për cilësinë, efikasitetin dhe suksesin e tij. Nxënia për të gjithë nxënësit, që garanton formimin e tyre në një nivel të caktuar, paraparakishtë si i domosdoshëm, përbën thelbin e suksesit të procesit mësimor.

Gjatë procesit të nxënies, çdo nxënës duhet:

- të orientohet dhe të ndërgjegjësohet përse duhet të punojë për arritjen e objektivave të nxënies nëpërmjet plotësimit të kërkesave dhe detyrave që i jepen;
- të kuptojë dhe të gjykojë pozicionin e tij në lidhje me objektivat: të kërkojë mbështetje dhe orientim për shkurtimin e kësaj distance;
- të gjykojë dhe të vlerësojë rezultatin e arritur;
- të dokumentojë progresin e bërë në përpjekjet e tij për të arritur objektivat;

- të reflektojë për rrugët e mundësitë për më tej.

Që vlerësimi të jetë objektiv dhe dokumentues i progresit real të nxënësit në lidhje me objektivat e nxënies, ai duhet të jetë shumëdimensional: vlerësim paraprak, vlerësim gjatë procesit të nxënies dhe vlerësim përmbledhës .

Vlerësimi paraprak: A zotërojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë e duhura për klasën e 11-të? A zotërojnë ata një pjesë të materialit që do t'u mësohet?

Rezultatet e këtij vlerësimi e ndihmojnë mësuesin për planifikimin e modulit, për përshtatjen e procesit mësimor ndaj aftësive dhe njohurive paraprake të nxënësve, për të garantuar kështu pjesëmarrjen dhe aktivizimin e natyrshëm të tyre në realizimin e veprimtarive mësimore individuale, në grup apo me të gjithë klasën.

Vlerësimi në procesin e nxënies: A po përparojnë nxënësit në mënyrë të përshtatshme drejt arritjes së objektivave? A ka nevojë për përmirësim të mësimdhënies? A vendoset theksi i nevojshëm në komponentët e duhur të mësimdhënies, të cilët do të përdoren edhe në mësimet pasardhëse?

Ky vlerësim duhet të zhvillohet në intervale të shpeshta dhe të dhënat e marra prej tij duhet të përdoren menjëherë për t'u përgjigjur nevojave të nxënësve si dhe përshtatjes së mësimdhënies. Çdo instrument vlerësimi i zhvilluar në klasë duhet të ketë të përcaktuar mirë kriteret e vlerësimit bashkë me sistemin e pikëve për nivelin minimal, mesatar dhe të lartë të plotësimit të tyre.

Mësuesit kanë nevojë t'u përgjigjen vazhdimisht pyetjeve të tilla si:

- A duhet të eci më përpara? A duhet të shpenzoj më shumë kohë në këtë fazë të mësimdhënies?
- A janë në gjendje nxënësit të zbatojnë në mënyrë të pavarur çfarë kanë mësuar? A duhet të jap udhëzime specifike shtesë?
- Nëse nxënësit nuk po arrijnë atje ku synojmë, çfarë duhet të ndryshojë për të arritur objektivat?

Në përpjekjet e tij/saj për të vlerësuar dhe monitoruar progresin e çdo nxënës/i,-eje, mësues/i,-ja siguron dhe analizon në kohë të dhënat e nevojshme në lidhje me nivelin e çdo nxënësi dhe të klasës në tërësi. Të dhënat që merr dhe përpunon, si dhe konkluzionet që nxjerr bazuar në to, mësues/i,-ja i/e lëndës i diskuton me mësuesit e tjerë për të identifikuar, gjykuar dhe rënë dakord bashkërisht për nevojat e nxënësve, për të vendosur se cilat strategji mësimore do të ishin më të efektshme.

Disa nga instrumentet që mësuesit përdorin për të matur progresin e nxënësve kundrejt objektivave mësimore të vendosura janë :

- vëzhgimet në klasë,
- detyrat me shkrim,
- parashtrimet gojore,
- minitestet,
- vlerësimet e standardizuara,
- etj.

Vlerësimi përmbledhës: A janë arritur objektivat mësimorë që lidhen me standardet ?

Vlerësimi përmbledhës nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara, por, bashkë me standardet dhe kurrikulën, përbën një tregues të vlefshëm dhe të besueshëm të thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e aftësive në situata të njohura dhe të panjohura. Ata duhet t'i analizojnë dhe vlerësojnë ato, duke shfrytëzuar të gjitha njohuritë dhe aftësitë e fituara përgjatë kursit të letërsisë. Nëse nxënës/i,-ja i zotëron aftësitë e tij/saj në mënyrë të mjaftueshme, ai/ajo duhet t'i zbatojë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies.

Megjithëse ka dhe shumë qëllime të tjera të vlerësimit, këto të tria, të listuara më sipër, janë vendimtare, pasi na informojnë për nivelin e mësimdhënies. Të marra së bashku, ato formojnë një hartë për arritjen e standardeve: pikën e nisjes, itinerari që duhet ndjekur, pikat në të cilat ky itinerar mund të ndryshohet dhe destinacionin.

Për sa më sipër, rezulton se thelbësore për suksesin e procesit mësimor janë lidhjet organike midis:

1. Vlerësimit dhe objektivave të arritjes;
2. Objektivave të arritjes me aftësimin e nxënësit në procesin e nxënies.

Përmes këtyre lidhjeve sigurohet koherenca midis objektivave nga njëra anë dhe punës mësimore për realizimin e tyre nga ana tjetër.

Në këndvështrimin e vlerësimit, merr karakter përgjithësues, finalizues dhe të dokumentuar lidhja midis objektivave të nxënies- procesit mësimor dhe rezultateve konkrete të tij .

Rezultatet e nxënies – formimi i pritshëm	VLERËSIMI I NIVELIT TË ARRITUR; DETYRA	
	A) Në përfundim të njësisë mësimore	B) Në përfundim të modulit
Analiza letrare e veprës - bazuar në kuptimin dhe zbërthimin e saj nëpërmjet ballafaqimit të drejtpërdrejtë me të.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fletët e punës të plotësuar individualisht. 2. Punim me shkrim rreth tematikave të veprës. 3. Diskutime në grup dhe në klasë. 4. bibliografia me shënime 5. Parashtrim gojor , me shkrim 6. detyra për leximin – diskutimi 7. prezantim. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Reflektim në tërësi për veprën. 2. Analizë ballafaqese me vepra, autorë ide dhe mesazhe të mësuara nëpërmjet letërsisë dhe fushave të tjera . 3. Formulim, parashtrim dhe evoluim i qëndrimit individual ndaj veprës. 4. krijime të mirëfillta mësimore 5. projekti mësimor i bazuara në vëzhgime, intervista, para dorëzimit ose prezantimit në klasë etj.

--	--	--

Për secilën nga këto aspekte të vlerësimit në përfundim të modulit mësuesi dhe nxënësit gjykojnë për punimet e tyre me shkrim dhe me gojë duke iu referuar kriterëve të paracaktuara dhe niveleve të realizimit të tyre. Kjo mënyrë vlerësimi përfundimtar dëshmon më mirë për progresin e bërë dhe nivelin e formimit të nxënësit në përfundim të modulit duke e lidhur atë me objektivat vjetore të nxënies.

Rubrikat për vlerësimin e punimeve me shkrim dhe të parashtrimeve gojore ndërtohen nga vetë mësuesi sipas modelit të mëposhtëm :

Kriteret e vlerësimit	NIVELET E PRITSHMËRIVE				
	Minimale	Mjaftueshëm	Mesatar	Mirë	Shumë mirë
1.					
2.					
3.					
4.					